



Udhëzime për OE dhe AK-se në përdorim dhe operim të sistemit të prokurimit elektronik për situata të shpeshta

1. Çfarë duhet të kenë parasyshë dhe kujdes përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik gjatë operimit në sistem?

- Të gjithë përdoruesit si nga ana e Operatorëve Ekonomik ashtu edhe nga ana e Autoriteteve Kontraktuese këshillohen që gjatë operimit dhe punës me sistem të prokurimit elektronik, **asnjëherë** të mos punojnë njëkohësisht të loguar në dy ose më shumë TABs në të cilët është hapur <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, por vetëm në një TAB apo faqe.
- Çdo operim me dy ose më shumë web faqe të hapura të eProkurimit mund të rezultoj në gabime të përdoruesit dhe të cilat do të jenë nën përgjegjësinë e tyre.




2. Si duhet të kenë parasysh/veprojnë Operatorët Ekonomik me përgaditjen dhe dorëzimin e ofertave?

- Gjatë përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave në një procedurë të prokurimit, Operatorët Ekonomik gjithmonë duhet të konsultohen me Manualin Udhëzues për OE të publikuar në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Manuals.pdf>
- Duhet që të gjitha dokumentet për ngarkim në sistem të jenë të ruajtura dhe strukturuara paraprakisht në kompjuterin personal me emërtimet dhe formatin përkatës dhe që gjatë ngarkimit të kujdesen që dokumenti i zgjedhur për ngarkim të mos jetë i hapur në kompjuterin personal.
- Nëse ka vonesa në ngarkim të ndonjë dokumenti, të kontrolloj nëse dokumenti është i hapur, ose nëse ka një kohë të gjatë i kyqur në llogari, të bëj Log-out dhe Log-in përsëri dhe të vazhdoj në hapin përkatës.
- **Të mos punojnë ose operojnë njëkohësisht në dy ose më shumë ndërfaqe të sistemit të e-prokurimit** (apo siç është ilustruar më lartë)
- Dhe gjithmonë, përgaditjen dhe dorëzimin e ofertës të mos e lënë për momentet e fundit para skadimit të afatit për dorëzim/hapje të ofertave.


3. Si duhet të veprojnë Operatorët Ekonomik me përgaditjen dhe dorëzimin e ofertave nëse procedura e prokurimit heqet nga statusi “në apel” gjatë fazës së dorëzimit të ofertave?

- Nëse procedura e prokurimit është dërguar në statusin “ne apel” për arsye të një ankese të pranuar, atëherë pas heqjes së së procedurës nga statusi “në apel” Operatorët Ekonomik të interesuar duhet të përgadisnin dhe dorëzojnë ofertë tërësisht të re.
- Pra, pavarësisht nëse kanë dorëzuar ofertën ose kanë filluar me përgaditjen e ofertës (vetëm kanë filluar me ngarkim të dokumenteve) para dërgimit të procedurës në “apel” , atëherë pas heqjes së procedurës nga “apeli”, Operatorët Ekonomik duhet të fillojnë përgaditjen dhe dorëzojnë ofertë krejtësisht të re. Përndryshe, nëse oferta përmbanë dokumente të ngarkuara para sttusit “në apel”, atëherë oferta e tyre bëhet e paqasshme dhe nuk mund te shkarkohet si ofertë e plotsi ofertë e plotë.
- Një këshillë të njejtë përdoruesit gjithmonë e pranojnë edhe në e-mail në momentin që autoriteti kontraktues e dërgon procedurën e prokurimit “në apel” (apo si në shembullin ilustrues më poshtë)




4. Si duhet të veprojnë Autoritete Kontraktuese në përgaditjen e Draftit të Kontratës dhe dërgimit tek Operatori Ekonomik për aprovim?

- Autoritetet Kontraktuese pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës B08 duhet të përgaditin Draftin e Kontratës – të cilën duhet t’a dërgojnë tek OE për aprovim vetëm pas publikimit të B08. Njoftimi B08 duhet të jetë me status **“publikuar”**
- Në rast se Drafti i Kontratës dërgohet para publikimit të njoftimit B08 (i cili është vetëm me status **“dërguar për publikim”**), atëherë drafti i kontratës nuk do të paraqitet nga ana e Operatorit Ekonomik të cilit i është dërguar.



5. Çfarë duhet të kenë parasyshë Autoritetet Kontraktuese gjatë komunikimit – shkëmbimit të letrave standarde, etj me Operatorët Ekonomik ofertues pas hapjes së ofertave?

- Autoritetet Kontraktuese gjatë komunikimit – shkëmbimit të **letrave standarde** dhe çfarëdo dokumenti me Operatorët Ekonomik ofertues **pas hapjes së ofertave**, duhet të kenë parasyshë që gjatë komunikimit të tillë **statusi** i procedurës së prokurimit duhet të jetë **“në vlerësim”**. Përndryshe, nëse statusi i procedurës është “dorëzimi i tenderëve” atëherë OE ofertues nuk do të pranojnë dokumentin dhe nuk do të pranojnë e-mail njoftues gjithashtu, dhe përgjegjësia do të bie mbi Autoritetin Kontraktues.



6. Si duhet të veprojnë dhe operojnë zyrtarët e prokurimit të AK-se në rastin e përdorimit të funksioneve për korrigjim të procedurës nëpërmjet formularit B54?

- Autoritetet Kontraktuese gjatë përdorimit të funksioneve për korrigjim të procedurës nëpërmjet formularit B54 duhet gjithmonë që të konsultohen me ***“Manualin udhëzues për përgaditjen dhe publikimin e Njoftimit për korrigjim B54”*** i cili është i publikuar dhe mund të shkarkohet nga sistemi i prokurimit elektronik në kuadër të manualeve – Manualet për Autoritete Kontraktuese: [Manual udhëzues për përgaditjen dhe publikimin e Njoftimit për korrigjim B54.pdf](#)